Иако се смета дека во својата стихотворбата „Мајка Македонија ги советува своите чеда да востанат против тиранијата на Турците" од 1889 година Марко Цепенков го најавил Илинден, во личноста и долото на Арсени Јовков – во песните од 1903 година и романот на стихови „Илинден" го распознаваме најголемиот поетски проект на илинденска тема во македонската литература реализиран токму од Арсени Јовков. Иако поетската творба е пишувана на бугарски јазик, како впрочем и сите негови други поетски и публицистички текстови, таа содржи вкупно стихови, а тематски е сместена во амбиент на родниот крај на авторот китните подрачја на високото Стогово. Во поемата се отсликани трагика и хероизмот на малиот македонски човек, во борбата против турските насилници и колку да е очигледен романтичарски занес на поетот, Илинден го изнесуваат на свои плешки новите Маркокралевци.

Поемата на Јовков завршува со стиховите:

„Жив е, жив е Марко Крале"! Оттука бесмртноста на Марко не е легенда туку жива вистина, бидејќи неговите продолжувачи (следбеници) му ја прелеваат славата низ векови. Затоа со право велиме дека Арсени Јовков е првиот вистински поет на Илинден. Ракописот на епската поема „Илинден" од Арсени Јовков се чува во архивот на МАНУ – Скопје.

Творечкиот портрет на Јовков се дополнува и со неколку мемоарски текстови. Такви се:„Спомен“, „Над Смилево“, „На свештеночинувањето во село Цапари“,

„Ников Гроб“ и„Првите денови на Илинденското востание“.

Арсени Јовков добрата половина на својот живот и ја подарил на Македонија препозната како идеја и идеал, како борба и акција. Незамомчен уште, тој и се оддава на татковината како народослужител и во огнените вирови на Илинден години како 20-годишник, израснува во борец, на одредите на самозаштита, низ ајдутските пазуви на легендарниот Караорман. Татко му и постариот брат ги положуваат животите на Илинден, а тој веднаш по пропаѓањето на Востанието, емигрирал во Бугарија за низ политички и културни акции да го дораскаже илинденското дело, за да биде конечно сопрен од куршумите на пробугарските македонски терористи во крвавите оргии на безумните братоубиства кон средината на септември 1924 година.

Зафатен со секојдневниот рискантен двобој со силите на реакцијата и среде македонската емиграција и бугарската јавност, немилосрдно раз-обличувајќи го традиционалниот и жилав бугарски шовинизам, но и македонскиот врховизам кој се појавува во ново фашизирано руво и ја презел улогата на јуришен одред во служба на бугарската буржоазија и дрвор, Арсени Јовков мечтаел и се борел Македонија да ја види како Република во составот на Балканската федерација, како единствен залог за нејзината иднина. Во името на овие идеали, речиси истовремено како и димо Хаџи Димов, тој порачувал:

„... Земјите што имаат народни манифести како што е Илинден 1903 година, не умираат, тие манифести стојат повисоко од договорите за мир, од политичките шпекулации, од трговија на народи“.

„Народите што го дале Илинден можат да дадат и втор“.

За овие идеали живееше, за овие идеали и загина Арсени Јовков.

Во таа, историски запаметена македонска вартоломејска ноќ, црни силуети на злото олицетворение во касапските специјалисти на Ванчо Михајлов, ѕверски го убиваат најавтентичниот македонски поет на Илинден.

Арсени Јовков е бездруго најизвонредниот, најсугестивниот и најнадаренот поетски глас на масовното посегање кон слободата. За жал, малкумина го знаат како поет. Повеќе е познат како публицист и новинар.

Во родното село на Арсени Јовков помеѓу Караорман и Стогово, денес не пулсира живот. Тоа село, како и многу други во тие западно-македонски краишта, денес е испустено од некој проклетилак, питомо, божја убавина, со многу блиско небо, самува денес среде тоа испустено село една мала плоча врз која се втиснати имињата на двајца наши истакнати литерати: Чернодрински и Јовков. Некаде блиску до ова село, чие име галено зазвучува низ формата на деминутивот Селце, се кријат низ ниската трева остатоци од Виа Игнација, остатоци што селаните од овој крај ги викаат Цеста. А поради некоја потешко објаснива постановка на историската сцена, во непосредна близина на оваа високопланинска населба, пак низ звучен хипокристик, се крие зад името Коџаџик некогашниот Светиград, каде што во далечното минато (14 век) славниот Скендербег го запрел турскиот навал и му нанел пораз на Балабан-паша, за што ни раскажува Глигор Прличев. Во Селце на Војдан Чернодрински и Арсени Јовков, на Воислав Илијашевиќ и на Цвето Мартиновски и на сликарот Божин Барутовски, во оваа убавина на дланка, каде што како што би рекол, Константин Миладинов природата сета своја раскош ја истурила, и на која човечкиот фактор и свртел грб, се раѓа, во годините што следат веднаш по крвавата Брсјачка буна или Охридски заговор, првиот поет на Илинден, за да остане нашата историја како утеха дека и во овие краишта биеле дамарите на животот, дека и тука се ткаела нашата скромна историја.

Весна Стефковска

Кадар од документарниот филм „Македонија“ го прикажува пренесувањето на останките на Гоце Делчев во црквата „Света Недела“
Kuadri i filmit dokumentar “Maqedonia” e shpjegon dërgimin e të mbeturave të Goce Dellçevit në kishën “E Diela e shenjtë”

"I tërë fisi im ishte betuar se do ti shërbej Maqedonisë dhe shumica prej tyre e dhanë jetën për lirinë e saj. Nëse nevojitet edhe jeta ime, unë do ta jap atë...Unë tani nuk mund të marrë pushkën dhe të luftoj, pushka ime është penda dhe unë me te luftoj".

Arseni Jovkov

ARSENI JOVKOV (1884-1924)

Ideja për çlirimin kombëtarë të popullit maqedonas, nga robëria osmane, përmes revolucionit nga të gjitha popujt e bashkuar, që janë elemente përbërëse të Maqedonisë, pa dallim të përkatësisë së tyre fetare dhe kombëtare, ka filluar të marrë një hov relativisht të madh në dekadën e fundit të shekullit XIX. Kjo ide, dalëngadalë do ti përfshij të gjitha shtresat e shoqërisë maqedonase dhe kah fillimi i shekullit XX do të shndërrohet në një fuqi të vërtetë materiale e cila do ti nxisë masat popullore për fillimin e Kryengritjes së Ilindenit, një prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e popullit maqedonas.

Nëse fshatarësia, si klasë më e madhe shoqërore, dhe klasa qytetare si shtresë e dytë për nga madhësia e shoqërisë së atëhershme maqedonase, kanë shërbyer si rezervuar prej ku janë farkuar kuadrot themelore për përgatitjen e kryengritjes, nga ana tjetër inteligjenca me proporcion më të vogël numerik, në veçanti shtresa e mësuesve, ka shërbyer si një fuqi e madhe kohezive e cila i ka bashkuar këto masa popullore, duke shtuar frymën revolucionare dhe vetëdijen për luftën e armatosur kundër tiranisë osmane.

Duke ndriçuar personalitetin e luftëtarit dhe krijuesit Arseni Jovkov (1884 - 1924), para një auditori ndërkombëtarë, menjëherë do të theksojmë faktin se për një figurë të tillë mbresëlënëse, ne po flasim prej një distance të madhe kohore (131 vite nga lindja, 112 vite nga Kryengritja e Ilindenit e vitit 1903 dhe 91 vite nga vdekja e tij tragjike). Për arsye se maqedonasit në Maqedoninë maqedonase gjatë këtyre 70 viteve të përkufizimeve të lira racionale, nuk kanë arritur që ti kushtojnë vëmendjen dhe meritën e nevojshme, zërit më autentik letrarë të Ilindenit të vitit 1903.

Arseni Jovkov i përket grupit më të madh ose kategorisë më të spikatur të veprimtarëve, të cilët për nga aspekti kohorë i përkasin tre dekadave të fundit të shekullit XIX dhe gjysmës së shekullit XX. Për këtë arse, në plejadën e revolucionarëve maqedonas, krijuesve shoqërorë letrarë dhe vizionarëve, që luftuan me pendë dhe me pushkë në dorë, vendi meritor i takon Arseni Jovkov, njërit prej udhëheqësve më të rinj të Kryengritjes së Ilindenit, poet i frymëzuar i luftës nacional çlirimtare, por nga ana tjetër edhe një publicistë temperament dhe zhurnalist pa kompromise, një tribun i dashur popullorë, bashkëluftëtarë, mik i afërt dhe bashkëmendimtarë i Gjorçe Petrovit.

Për fat të keq, njësoj sikur edhe pjesa më e madhe e djemve më të spikatur të popullit tonë, nga e kaluara e afërt dhe e largët revolucionare, edhe ai do të vritet në moshën e lulëzimit të fuqive krijuese. Në kohën kur me tortura shtazore do të

shuhet kënga e tij, fjala inkurajuese e thurur me entuziazëm, ai porsa ka mbushur 40 vite. Por, duke jetuar dhe vepruar në njërën prej periudhave kalimtare të popullit tonë, i frymëzuar nga valët e pamposhtura të luftës nacional çlirimtare, të cilat Arseni Jovkov me të drejtë do ti quaj si revolucion gjithë popullorë, ai do të zhvillohet si njëri prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të gjeneratës së dytë të revolucionarëve dhe krijuesve maqedonas, të cilët jo vetëm që i kanë pasuar idealet e Goce Dellçevit, Gjorçe Petrovit dhe Jane Sandanskit, por edhe e kanë fisnikëruar dhe thelluar mendimin shoqërorë - politik dhe praktikën konkrete revolucionare.

Arseni Jovkov ka lindur në fshatin Sellce (në ditët e sotme ky fshat është braktisur nga banorët e tij, për nga aspekti administrativ fshati ka qenë i pozicionuar në rrethin e Strugës - Drimkoll, në afërsi të elektro centralit të ri Glloboçica) më datën 25 mars të vitit 1884. Ky është njëri prej fshatrave më të largëta të Maqedonisë Perëndimore, i cili për nga pasiviteti i tij ka qenë i njohur edhe si fshat kurbetçarë, i fshehur nën sqetullat e bukura të malit të Stogovës, në këtë fshat në vitin 1875 ka lindur edhe Vojdan Çernodrinski, themelues i teatrit dhe dramës maqedonase.

Edhe pse fshati Sellce, deri para ca kohe nuk kishte rrugë, banorët e këtij fshati kanë udhëtuar në kërkim të fitimit në katër anët e botës, çdo herë duke u rikthyer me njohuri të reja, por edhe me bindje se robërisë dhe krimeve njëherë duhet tu jepet fundi.

Fshati Sellce ka qenë në shënjestër të grabitjeve nga ana e bandave kriminele të cilat në këtë periudhë kohore, por edhe para saj, e kanë shkretuar tërë Maqedoninë Perëndimore.

Për këtë arsye, fshatarët e Sellces, kanë qenë të detyruar që shumë herët të vetë organizohen dhe vetëmbrohen, shumë kohë para themelimit të Organizatës së brendshme revolucionare, dhe në kohën kur kjo organizatë do të themelohet, ata me masovitet do të bashkëngjiten në radhët e saja luftarake.

Arseni Jovkov, dëshmon se fshatarët e Sellces, edhe në kishë kanë shkuar të armatosur. Arseni Jovkov i përket një familjeje të njohur, babai i tij Tanasko, ka qenë njëri prej banorëve më të njohur dhe më të vetëdijesuar për nga aspekti kombëtarë në fshatin Sellce. Ai duke u kthyer nga lufta Serbo - Turke e vitit 1876, në fshatin Sellce ka sjell dy kambana, të cilat sipas Jovkovit për herë të parë në fshatin e tij kanë trumbetuar dhe paralajmëruar kohën e re. Duke i falënderuar Tanaskos, në fshatin Sellce do të hapet edhe shkolla e parë shekullare, kurse ai së bashku me të parët e fshatit kanë kontribuar që të dëbohet peshkopi grek i Dibrës. Edhe më mbresëlënës ka

qenë kontributi i Tanaskos gjatë vetë organizimit të fshatarëve për mbrojtjen nga bandat e hajdutëve. Por për shkak të mos nënshtrimit të tij, babai i Arseni Jovkov, jo vetëm që do të burgoset dhe torturohet, por edhe do të vritet në pritë. Vdekja e tij martire, nuk do ti frikësojë djemtë e tij Nikon dhe Arsenin. Djali më i moshuar Niko, do të bëhet njëri prej organizatorëve të lëvizjeve revolucionare të asaj ane (përndryshe ai ka qenë mësues në Dibër), por ai do të vdes në afërsi të fshatit Mramorec më 11 gusht të vitit 1903, gjatë hovit të Kryengritjes së Ilindenit. Vendin e prehjes së mësuesit nga fshati Sellce, Niko Tanaskov, shpirtit të çetave të malësisë, populli për nderë të tij do ta quaj si Varri i Nikos. Djali më i ri i Tanasko Jovkov, Arseni arsimohet në fshatin Sellce, Dibër dhe në Manastir.

Vala revolucionare që ka përfshirë tërë Maqedoninë, do ti përfshijë edhe të gjithë nxënësit e klasave të larta të Gjimnazit të Manastirit, të cilët janë organizuar në trajtë të qarqeve revolucionare, të shpërndara në grupe prej 15 - 20 vetave, të udhëhequra nga dhjetari, të përgatitur me qëllim të pritjes së kryengritjes. Përgjegjës i një grupi të tillë në vitin 1903 ka qenë nxënësi i klasës së shtatë në Gjimnazin e Manastirit, Arseni Jovkov, i cili në atë kohë ka qenë i nxitur nga vrulli i lindur krijues dhe nga entuziazmi revolucionarë, në këtë kohë ai tani më është njoftuar me shprehjen poetike dhe i ka mbushur fletoret me vargje poetike.

Periudha e viteve 1900 - 1903, është periudhë kohore kur Arseni Jovkov do ti bëjë hapat e para poetike, dhe si dëshmi e pjekurisë së tij krijuese është poema nga jeta maqedonase "Mallkimi", e përfunduar në vitin 1901, e publikuar në revistën "Dita" me numër 612 e muajit shkurt të vitit 1905 në Varna.

Kryengritja e Ilindenit, atij nuk do t'ia ndërpresë ethet poetike. I frymëzuar nga jeta e popullit të tij, vuajtjet dhe dhembjet e të cilit, atij qysh në moshën e mitur gjerë do t'ia hapin zemrën dhe shpirtin, dhe duke u mbështetur në thesarin e pashterur të poezisë popullore, i riu Jovkov do ta bashkoj në një tërësi të vetme, zjarrin revolucionarë dhe frymëzimin poetik. Ky do të jetë lajtmotivi themelorë i cili do të zvarritet në tërë opusin e krijimtarisë së tij poetike, gjithashtu ai do të reflektohet edhe në veprimtarinë e tij zhurnalistike dhe publicistike.

Duke u farkuar dhe pjekur në ditët e stuhishme të epopesë maqedonase, në të cilën ai do të marrë pjesë si sekretar i çetës rajonale të vojvodës së rajonit të Ohrit dhe malësisë, vojvodës Tase Hristov, duke marrë pjesë në marshimet e gjata mbinjerëzore dhe luftës me hordhitë e bashibozukëve dhe me ushtarët e shumtë të Bahtijar pashës, mirënjohjen më të madhe, gjimnazisti, poeti dhe revolucionari i ri do ta fitoj me nderin që i jepet nga Komiteti revolucionarë i Manastirit, që së bashku me shokun e tij të shkollës Dragan Zografov, ta vizatojnë flamurin e Rrethit kryengritës të Manastirit, flamur që ka valuar në zjarrin e Ilindenit, duke i shkrirë në vete idealet shekullore dhe synimet e popullit tonë të përcjellë me moton «Liri ose vdekje», të cilin me dorën e tij do ta shkruaj vetë Arseni Jovkov.

Nën hijen e këtij flamuri, do të luftoj edhe vet gjimnazisti porsa i përfunduar në Gjimnazin e Manastirit, por edhe përskaj faktit se ai fuqishëm do të grabis pushkën në dorë, ai prapëseprapë nuk e harron pendën. Qysh prej çastit të parë kur prej

bankave shkollore do të arrij në radhët e çetës, dhe deri në shkëndijat e fundit të zjarrit të Kryengritjes së Ilindenit, ai do ti thur vargjet që do ti ruaj së bashku me urdhrat dhe porositë e shifruara në çantën sekretariate të lëkurës. Kështu ai me sukses do ti ruaj, duke shënuar çdo poezi ku dhe kur është e shkruar. Prej kësaj periudhe kohore do të ruhen poezitë: "Era fryn", "Rrëfimi", "Ëndrra e komitëve", "Martirët e dimrit" dhe të tjera.

Duke i shkrirë thellë në zemër porositë dhe mësimet e Kryengritjes së Ilindenit, i riu Jovkov, si dhe shumë kryengritës të tjerë që mbijetuan kryengritjen, para rreziqeve që me vete i ka sjell dimri i vitit 1903, do ta kaloj kufirin me Greqinë.

Në qytetin Llarisa ai do të burgoset dhe pas tre muajve kur me sukses do arratiset nga burgu, nga Athina me anije do të transferohet në Varna, ku do të pranohet dhe ndihmohet nga emigracioni maqedonas, i cila në atë kohë ishte strehuar në këtë qytezë të detit të zi. Gjatë arritjes në Bullgari, ai në mënyrë aktive do të marrë pjesë në radhët dhe aksionet e emigracionit politik maqedonas. Këtu do të prezantohet si autorë i librave poetike, zhurnalist dhe publicist, duke i komentuar gjendjet në Maqedoni. Ai ka zhvilluar një aktivitet të gjerë poetik dhe shoqërorë - politik, kurse punimet dhe qëndrimet e veta do ti shtroj në gazetën "Zëri i lirë", pronarë i së cilës ka qenë Stefan Petkov nga Ohri. Përmes kësaj gazete, Arseni për herë të parë do të depërtoj në sekretet e zhurnalistikës dhe do ti shqyrtoj mundësitë që i ofron zhurnalistika gjatë realizimit të ideve dhe qëndrimeve të tija politike. Më vonë, ky profesion atij do ti mbetet si përcaktim jetësorë.

Në Varna, edhe pse tërësisht ka qenë i preokupuar me punën në gazetën "Zëri i lirë", Jovkov në vitin 1905 e ka shkruar poemën e parë "Qartngrohësit", kurse prej gjuhës ruse ai do ti përkthej poemat e Bajronit "Çajlld Harlld" në vitin 1905 dhe "Nusja e Abidonit" në vitin 1906.

Në vitin 1909 në Varna, në iniciativë të tij, në vendim ku ka qenë i fokusuar emigracioni maqedonas nga Maqedonia Perëndimore, do të themelohet dega e shoqatës bamirëse nga Dibra "Sofja", dhe ai do të emërohet si kryetarë i saj. Në të njëjtën kohë, sërish në iniciativë të tij, shoqata do të themeloj organin e saj "Zëri i Dibrës" në të cilin Arseni do të marrë pjesë në masë të konsiderueshme. Deri në kohën e transferimit në Sofje, në vitet e para të Luftës së Parë Botërore, Arsenin rruga jetësore do të shpij përmes ndodhive të përgjakshme të Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, por edhe drejtë fisnikërimit të jetësorë dhe politikë.

Duke vënë jetën e tij në shërbim të mëmëdheut, qysh prej fëmijërisë - fati i mëmëdheut do të bëhet edhe fat i Arsenit. Në luftën për liri, Arseni Jovkov do ta flijoj jetën e tij në njërin prej vendeve më të spikatura të frontit luftarak - në vendin e redaktorit të gazetës "Ilinden", organ i luftëtarëve të vjetër të Ilindenit. Përskaj disa përmbledhjeve të lartpërmendura të poezive, të cilat datojnë prej viteve të rinisë, pas vdekjes së Jovkovit, në trashëgimin e tij janë gjetur edhe poemat "Mysafirët" dhe "Shën Jovan Bigorski" si dhe disa poezi të frymëzuara nga Epopeja e madhe e Ilindenit, gjithashtu edhe poema "Ilinden" dhe poezitë "Ndarja" dhe "Toka" të cilat i ka botuar në gazetën "Ilinden".

Më vonë, portreti poetik i Jovkovit do të pasurohet me një numër të madh të artikujve gjuhësore, kritike - letrare, folklorike, memoare dhe në veçanti artikujve publicistike, me të cilat ai do të hyjë përmes dyerve të mëdha në publicistikën maqedonase. Në fakt, ky aktivitet i tij kishte filluar para se të merrej me botimin e gazetës "Ilinden".

Arseni Jovkov, në historinë tonë kulturore, po zbulohet tani, në kohët e sotme, për arsye se kemi të bëjmë me një intelektual të rrallë maqedonas i cili fuqitë e veta shpirtërore i ka fokusuar në më shumë fusha kulturore, në mesin e të cilave më shumë në zhurnalistikë. Në këtë drejtim, zhurnalistika duke u shfaqur si degë e pavarur dhe si medium përmes të cilit është manifestuar shpirti rebel i Jovkovit dhe i pasardhësve të tij, në veçanti gjatë viteve të para të dekadës së tretë të këtij shekulli, zhurnalistika atij do ti shërbej si mjet përmes të cilit do të vijnë në shprehje më shumë veprimtari shpirtërore: poezia e tij, kritika, historia dhe analizat e shkëlqyera të ngjarjeve para dhe pas Kryengritjes së Ilindenit, por para se gjithash artikujt që kishin të bëjnë me çështjen maqedonase, në fazën kur kjo çështje ishte e aktualizuar menjëherë pas Luftës së Parë Botërore.

Në katrahurat politike të emigracionit maqedonas, pas Luftës së Parë Botërore dhe pas polarizimit të saj në rrymat e gjera demokratike, nën ndikimin e ndodhive të mëdha sociale dhe rrymave të cilat menjëherë janë vënë nën shërbimin e oborrit dhe qeverisë bullgare, të cilat e kanë vazhduar rolin e "vërhovistëve" në radhët e lëvizjes maqedonase, Jovkov jo vetëm që do të radhitet në mesin e të parëve, por ka qenë edhe ideologu i tyre.

Duke ushtruar detyrën e redaktorit të gazetës "Ilinden", Jovkov në programin e tij do ti regjistroj

Селото Селце родниот крај на Арсени Јовков
Fshati Sellce vendlindja e Arseni Jovkovit

të gjitha elementet progresive të luftës së popullit maqedonas, nga e kaluara por edhe ato elemente dhe dukuri që kanë qenë rezultat i zhvillimit historik të njerëzimit dhe kushteve moderne, në veçanti ndarjen e Maqedonisë në mes tre shteteve fqinje: Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë. Në këtë drejtim ka qenë e fokusuar e tërë lëvizja maqedonase, kurse Jovkov ka qenë i pozicionuar në njërin prej punkteve më të rëndësishme në Sofje, në çerdhen e atyre rrymave të cilat fuqishëm anonin prapa ose anash, duke rezistuar ose duke u orvatur në mesin e emigracionit në Bullgari, me qëllim të mbjell idetë e reja.

Jovkov nuk ka qenë komunist, por në suaza të ideve të reja demokratike dhe traditave nga e kaluara, ai ka vepruar me angazhime të mëdha, në fund duke e sakrifikuar edhe jetën e tij. Gazetën e vogël, njësoj sikur që kishte filluar edhe me gazetën "Ilinden", më vonë ai do ta riorganizoj në një gazetë që do ta shkund qeverinë e Bullgarisë dhe fuqitë djathtiste në radhët e lëvizjes maqedonase, Arseni Jovkov, mësues fshati, bëhet zhurnalist i kalibrit të madh, i cili në rend të ditës do të shtroj një sërë problemesh të natyrës së ndërlikuar që kishin të bëjnë me çështjen maqedonase. Jovkov, zhurnalistikën e ka kuptuar si armë më përkatëse për vazhdimin e luftës kombëtare. Ai me artikujt e tij të botuara në revistën "Ilinden", shumë herë e ka theksuar rëndësinë dhe rolin e kësaj "arme" në duart e maqedonasve.

Jovkov, si redaktor dhe zhurnalist i ka redaktuar dhe botuar gazetat "Pirin" dhe "20 korriku" (çdo herë kur policia e ka ndaluar gazetën "Ilinden" ajo është botuar me emër tjetër të ri). Mes tjerave, për zhurnalistikën maqedonase, Arseni Jovkov thotë:

"Organet tona janë të nevojshme, jo vetëm për propagandën e veprave tona. Por ato duhet të jenë edhe rregullues, edukues, kandila të shpirtrave, zemrave dhe mendjeve tona.

Edhe më shumë për faktin se vepra maqedonase, për çdo ditë po ballafaqohet me probleme të reja, edhe për shkak të faktit se ajo ka depërtuar më thellë në rrugën drejtë internacionalizmit, për arsye se është bartës jo vetëm i një mendimi revolucionar të marrëveshjeve, interesave dhe *hutive, por edhe bartës i një ideje për federatën ballkanike, për një vëllazëri të atyre kombësive maqedonase të cilat dje luftonin dhe të cilët do të luftojnë edhe sot.*

Dhe në rast të tillë, çfarë duhet të bëjmë?

Është kohë e fundit që të zbulojmë nevojën për ngritjen e *saj, zgjerimin, përsosjen dhe ajo kryesorja, përcaktimi final të roleve të shtypit bullgar dhe shtypit maqedonas, dhe gjatë kësaj për maqedonasit, ky i fundit duhet të jetë mësim ungjilli ...."*

Emigracionit, i cili para shfaqjes së gazetës "Ilinden", ishte në gjumin e thellë dhe të rehatshëm të ëndrrës së letargjisë së pakuptimtë, e cila prej fallxhorëve politik emërohej si "njëmendësi e plotë" dhe "bashkim", përnjëherë ka kaluar në një lëvizje të pazakontë. Gazeta "Ilinden" është shndërruar në një udhëheqës shpirtërorë të emigracionit maqedonas dhe i adhuruar i saj. Gazeta dalëngadalë ka përhapur ndikimin e saj në masat e gjera popullore dhe gjatë kësaj i ka përgatitur që ti refuzojnë gabimet dhe mashtrimet nga e kaluara. Penda e Arseni Jovkovit i ka shqetësuar dhe e ka

gërryer prestigjin e tyre, i ka demaskuar në mënyrë të ashpër, dhe ajo që ka qenë më e tmerrshme për të njëjtit, është fakti se ata profesorë "të famshëm" kanë mbetur shumë prapa nën hije, pa kurorat politike dhe zhurnalistike, prej një mësuesi nga fshati, i cili për çdo ditë i ka fituar simpatitë e masave popullore.

Në këtë gazetë, më 17 prill të vitit 1924, Jovkov do ta shpall Memorandumin historik, të përpiluar nga ana e tij dhe të botuar nga udhëheqësia e Organizatës së Ilindenit. Në këtë dokument, me kritikë të ashpër do të sulmohet diktatura fashiste e kryetarit të asaj kohe të qeverisë bullgare, profesor Aleksandar Cankov. Për shkak të kësaj shpalljeje, mendohet se më vonë ai do të vritet. Krimi do të realizohet në Gorna Xhumaja (Bllagoevgradi i sotëm) në Maqedoninë e Pirinit më 14 shtator të vitit 1924, nga ana e bandave të Vanço Mihajllovit, i cili ka qenë në shërbim të fashistëve bullgar.

Arseni Jovkov ka jetuar 40 vite dhe ka mbetur në kujtime si revolucionarë i denjë maqedonas, i cili ka jetuar dhe vepruar në pajtim me parimet e virtytshme dhe morale të plejadës së Goce Dellçevit, plejada e mbrojtësve të Maqedonisë: Gjorçe Petrov, Dimo Haxhi Dimov, Jane Sandanski, Petar Pop Arsov. Në artikujt hyrëse të redaksisë, dhe në të gjitha përgatitjet për gazetën e tij, ai ka luftuar kundër shovinizmit dhe tentativave të ngjashme të shteteve ballkanike që preknin pavarësinë e Maqedonisë, e në veçanti ndarjen e paskrupullt të Maqedonisë.

Gazeta "Ilinden" ka qenë tribuna e maqedonasve të përparuar në Bullgari. Talenti i lartë i Arseni Jovkov, si publicist rajonal dëshmohet me artikujt: "Manastiri po vdes", "A ekzistojnë pakicat" dhe "Kryengritja e Ilindenit në histori". Vija jetësore e Arseni Jovkov e cila zhvillohet në katër dekada të përpjekjeve të mëdha që të kapet hapi i kohës, të depërtohet nëpër skemën e ngjarjeve historike dhe të lënit gjurmë të përhershme prapa vetes, do të kuptimësohet edhe përmes orvatjeve që të investohet edhe në fjalën letrare.

Fillet e poezisë së Jovkovit përputhen me pjesëmarrjen e tij në revolucionin e përgjakur dhe me defetizimin e një dështimi gjithë popullorë. Edhe pse konsiderohet se me përmbledhjen e tij të poezive «Nëna Maqedoni i këshillon fëmijët e saj që të zgjohen kundër tiranisë së turqve» të vitit 1889, Marko Cepenkov e ka paralajmëruar Kryengritjen e Ilindenit, në personalitetin dhe veprën e Arseni Jovkov - në poezitë e vitit 1903 dhe në romanin në vargje "Ilinden" mund të dallohet projekti më i madh poetik në temën e Ilindenit në saje të letërsisë maqedonase, të realizuar saktë nga Arseni Jovkov. Edhe pse krijimtaria poetike është shkruar në gjuhën bullgare, njësoj sikur edhe të gjitha tekstet tjera poetike dhe publicistike, ajo në përgjithësi është thurur në vargje, të cilat për nga aspekti tematik përkunden në ambientin e vendlindjes së autorit, në viset e lulëzuara të Stogovës. Në poemën janë të pasqyruara tragjedia dhe heroizmi i njeriut të zakonshëm nga Maqedonia, në luftën kundër okupatorit turk, dhe sado që të jetë i pranishëm entuziazmi romantik i poetit, Ilindenin mbi supet e tyre e bartin Mbretërit Marko të rinj.

Poema e Jovkovit përfundon me vargjet:

„I gjallë, i gjallë është Mbreti Marko"! Prej këtu, pavdekshmëria e Markos nuk është legjendë por një e vërtetë e gjallë, meqenëse pasuesit e tij po e përhapin dhe trashëgojnë lavdinë e tij përgjatë shekujve. Për këtë arsye, me të drejtë sajohet konstatimi se Arseni Jovkov është poeti i parë i vërtetë i Ilindenit. Dorëshkrimet e poemës epike "Ilindeni" të Arseni Jovkov, ruhen në arkivin e ASHAM - Shkup.

Portreti i krijimtarisë së Arseni Jovkov, plotësohet edhe me disa tekste të memoareve. Të tilla janë: "Kujtimi", "Mbi Smilevë", "Gjatë emërimit të priftërinjve në fshatin Capar", "Varri i Nikos" dhe "Ditët e para të Kryengritjes së Ilindenit".

Arseni Jovkov, gjysmën e jetës, rininë ia ka kushtuar Maqedonisë, gjysma e njohur si ide dhe ideal, si luftë dhe aksion. I pa heshtur, ai i dorëzohet mëmëdheut si shërbëtorë i popullit edhe në dredhat e zjarrta të Ilindenit, në moshën 20 vjeçare ai do të radhitet në aradhet e vetëmbrojtjes, i strukur në sqetullat e hajdutëve të Karaormanit legjendarë. Babai dhe vëllai më i vjetër i tij do ti flijojnë jetët në Ilinden, kurse vet ai menjëherë pas shuarjes së Kryengritjes do të imigroj në Bullgari, dhe përmes një sërë të aksioneve politike dhe kulturore të përfundoj rrëfimin e veprës së Ilindenit, që së fundi të pengohet me plumbat e terroristëve maqedonas pro bullgar, gjatë orgjive të përgjakura dhe vëllavrasjeve të çmendura që u zhvilluan kah mesi i muajit shtator të vitit 1924.

I zënë me dyluftimet e rrezikshme që për çdo ditë zhvilloheshin me fuqitë e redaksisë dhe në mes emigracionit maqedonas dhe opinionit bullgar, duke ndriçuar pa mëshirë shovinizmin tradicional bullgar, por edhe "vrhovizmin" maqedonas i cili shfaqej me rroba të reja të fashizmit, që do të marrin rolin e aradheve sulmuese në shërbim të borgjezisë dhe oborrit bullgar, Arseni Jovkov ka

Ѓорче Петров, Арсени Јовков и Георги Поп Христов
Gjorçe Petrovi, Arseni Jovkovi dhe Georgi Pop Hristovi.

ëndërruar dhe ka luftuar që Maqedoninë ta shoh si Republikë në përbërjen e Federatës Ballkanike, si garanci e vetme për ardhmërinë e saj. Në emër të këtyre idealeve, pothuajse në të njëjtën kohë sikur edhe Dimo Haxhi Dimov, ai ka porositur:

„... Shtetet që posedojnë manifeste popullore siç është Ilindeni i vitit 1903, nuk vdesin, këto manifeste qëndrojnë më lartë se marrëveshjet paqësore, më lartë se spekulimet politike, më lartë se tregtitë e popujve".

„Popujt që kanë dhënë Ilindenin, mund ta përsëritin atë".

Për këto ideale jetoi, për këto ideale edhe vdiq Arseni Jovkov.

Në atë natë historike, natë të Bartolomeut maqedonas, siluetat e zeza të së keqes, shëmbëlltyrë e specialistëve të Vanço Mihajllovit, në mënyrë shtazore do ta vrasin poetin më autentik të Ilindenit.

Arseni Jovkov, pa mëdyshje është zëri më i mrekullueshëm, më i talentuar dhe zëri më sugjerues poetik i synimeve drejtë lirisë. Për fat të keq, pakica e njohin atë si poet. Ai më shumë njihet si publicist dhe gazetarë.

Në fshatin e lindjes së Arseni Jovkov, fshatin që shtrihet në mes Karaormanit dhe Stogovës, sot nuk pulson jeta. Ky fshat, si edhe shumë fshatra të tjerë në këto vise të Maqedonisë perëndimore, sot është i shkretuar prej ndonjë mallkimi, por në të gjendet e vetmuar një pllakë të vogël, një bukuri hyjnore, afër qiellit të çiltër, pllakë mbi të cilën janë shkruar emrat e dy letrarëve tanë të spikatur: Çernodrinski dhe Jovkov. Diku afër këtij fshati, emri i të cilit tingëllon përmes formës së diminutivit Sellce, nën barin e ulët fshihen mbeturinat e Vija Ignacia, mbeturina të cilat fshatarët e këtyre viseve i quajnë si Cesta. Dhe për shkak të një teze që vështirë mund të sqarohet në skenën historike, në afërsi të këtij vendbanimi në viset e larta malore, përmes hipokristikut të zëshëm, prapa emrit Koxhixhik fshihet Svetigradi i dikurshëm, ku në të kaluarën e largët (shekulli XIV), Skënderbeu i famshëm ka ndaluar sulmin e turqve duke e mposhtur Ballaban pashën, ngjarje të cilën e rrëfen edhe Gligor Përliçev. Në Sellcen e Vojdan Çernodrinskit dhe të Arseni Jovkovit, të Voisllav Ilijasheviqit, të Sveto Martinovskit dhe të piktorit Bozhin Barutovski, në këtë bukuri në pëllëmbën hyjnore, në të cilën sikur që thoshte Konstatin Milladinov, natyra gjithë bukurinë e saj e ka derdhur, dhe së cilës faktori njeri ia ka kthyer shpinën, në vitet që pasojnë menjëherë pas Kryengritjes së përgjakshme të Bërsjakut ose Komplotit të Ohrit, do të lind poeti i parë i Ilindenit, që të mbetet si ngushëllim në historinë tonë fakti se edhe në këto vise kanë pulsuar damarët e jetës, se edhe këtu është thurur historia jonë modeste.

Vesna Stefkovska

УСАИД обуки

Trajnime USAID

Ораторство / Oratoria

Актив по англиски јазик /
Aktivi për gjuhë angleze

Меѓународни активности / Aktivitete ndërkombëtare

Литературни дружења /Shoqërime letrare

Училишни компании / Kompani shkollore

MAK TRAVEL AGENCY
19 10:33

BEAUTY
CORPORATION

A.J. CORPORATION
Skopje - Macedonia
Corporation

Enter the world of

ECO COMPA

A.J. Corporation

A.J. CORPORATION
MACEDONIA
A.J.Corporation

Мултиетнички проекти / Projekte multi etnike

СУГС„АРСЕНИ ЈОВКОВ"

USAID

UNITED WE STAND,
DIVIDED WE FALL!

Вечер на македонскиот јазик / Mbrëmja e gjuhës maqedonase

Драмска секција / Seksioni i dramës

EENEDHONE

9MAJ

9MAJ

Медиумски гостувања / Prezantime në mediume

Ние сме најдобри / Ne jemi më të mirët

Спорт и спортски активности / Sport dhe aktivitete sportive

Матурски квадрил / Kadrili i maturës

Училишни проекти / Projektet e shkollës

СУГС „АРСЕНИ ЈОВКОВ"

Хуманитарни активности / Aktivitete humanitare

Проекти со локалната заедница / Projekte me bashkësinë lokale

Екскурзии / Ekskursione

TRAVEL AGENCY